



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.21, datë 23.07.2014

PËR

“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 3, DATË 26.02.2014: “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.2, DATË 30.03.2009 MBI “MIRATIMIN E RREGULLORES, PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TAKSI NË QYTETIN E TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 32, shkronja “k”, nenit 33 pika 2 të ligjit nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar) dhe nenit 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), duke marrë shkas nga shqetësimet e ngritura nga subjektet taksi që kanë aplikuar për rinovimin e licencave por që nuk janë trajtuar sipas vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 3, datë 26.02.2014 për shkak se aplikimi është bërë para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në respektim të parimit të barazisë, duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit Bashkiak ishte që me vendimin nr. 3, datë 26.02.2014 të zgjidhej problematika edhe e kësaj kategorie, me propozim të Këshillit Bashkiak

V E N D O S I:

1. Pika 1 e vendimit nr. 3, datë 26.02.2014 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 2, datë 30.03.2009 mbi “Miratimin e rregullores, për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Qytetin e Tiranës””, ndryshon si më poshtë:
 - *Për të gjitha subjektet e shërbimit taksi që rinovojnë licencën gjatë vitit 2014, duke përfshirë aplikimet nga data 1 janar 2014, vetëm për plotësimin e kriterit të përcaktuar në nenin 39 në lidhje me vitin e prodhimit të mjetit, afati i përmbushjes së tij shtyhet me dy vite kalendarike”.*
2. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI